



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

2021:087355

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu si dhe bashkëpunëtorin profesional Fatlum Halimi, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditësve: H.Q. nga G.E., Komuna Shtime, si dhe M.A. nga Komuna Ferizaj, të cilët me autorizim i përfaqëson Behar Sejda avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura Shtetërore me seli në ish-Pallatin e Rilindjes, Prishtinë, për shkak të shpërblimit të shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit, pagave jubilarë dhe pagës së trembëdhjetë, më dt.15.04.2024, jashtë seancës, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET pjesërisht** kërkesëpadia e paditësve H.Q. nga G. i E., Komuna Shtime, si dhe M.A. nga Komuna Ferizaj, si e bazuar.

**II. DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, që paditësve t’ua kompensoj shpërblimin jubilar dhe pagën e 13-të për periudhën nga data 14.11.2018 deri më dt.14.11.2022 dhe atë si në vijim:

1. Paditësit **H.Q.** në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës tek e paditura, t’ia paguaj 50% të një page bazë apo shumën prej 281.62 €, si dhe në emër të pagës së 13-të për katër vite (viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021) t’ia paguaj nga 563.25 € për çdo pagë (për katër vite shumën totale prej 2,253.00 €) apo shumën e tërësishme prej **2,534,62 €** (dymijë e pesëqind e tridhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë e dy cent) për të dy format e shpërblimit.
2. Paditësit **M.A.** në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës tek e paditura, t’ia paguaj 50% të një page bazë apo shumën prej 284.56 €, si dhe në emër të pagës së 13-të

për katër vite (viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021) t'ia paguaj nga 569.13 € për çdo pagë (për katër vite shumën totale prej 2,276.52 €), apo shumën e tërësishme prej **2,561.08 €** (dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një euro e pesëdhjetë e dy cent) për të dy format e shpërblimit.

**III. DETYROHET** e paditura që shumat e cekura në paragrafin II pika 1 dhe 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ua paguaj paditësve me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë më dt.07.05.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 196.00 €, të gjitha në afat prej 7 ditës pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

**IV. DETYROHEN** paditësit që paraprakisht dhe në mënyrë solidare të paguajnë taksën gjyqësore shtesë për paraqitje të padisë në shumë prej 20.00 €, menjëherë pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave juridike.

**V. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve përtej shumave të aprovuara si në paragrafin II pika 1 dhe 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë si në vijim: paditësit H.Q. i refuzohet shuma prej 281.62 € në emër të kërkesës për shpërblimin jubilar, i refuzohet kërkesa për pagën e trembëdhjetë për vitin 2022 në shumë prej 563.25 €, i refuzohet kërkesa për shpenzimet e ushqimit në shumë prej 2,607.50 €, si dhe i refuzohet kërkesa për shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 732.20 €; ndërsa paditësit M.A. i refuzohet shuma prej 284.56 € në emër të kërkesës për shpërblimin jubilar, i refuzohet kërkesa për pagën e trembëdhjetë për vitin 2022 në shumë prej 569.13 €, i refuzohet kërkesa për shpenzimet e ushqimit në shumë prej 2,607.50 €, si dhe i refuzohet kërkesa për shpenzimet e udhëtimit në shumë prej 732.20 €, si të pabazuara.

### **A r s y e t i m i**

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre më dt.07.05.2021 kanë paraqitur padi pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, përmes të cilës kanë kërkuar shpërblimin e shujtave ditore, shpenzimeve të udhëtimit, pagave jubilarë si dhe shpërblimin e pagës së trembëdhjetë, për periudhën nga dt.14.11.2018 deri më dt.14.11.2022.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre më vonë me parashtrësë e kanë precizuar kërkesëpadinë e tyre, ashtu që tani e tutje kërkojnë shumat si në vijim: për paditësin H.Q. në emër

të shpenzimeve të ushqimit ka kërkuar nga 2.5 euro në ditë apo për 1086 ditë pune në shumë prej 2,607.50 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 1086 ditë pune ka kërkuar shumën e tërësishme prej 732.20 €, në emër të dy pagave jubilarë ka kërkuar shumën e tërësishme prej 563.25 €, si dhe në emër të pagës së 13-të për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ka kërkuar nga 563.25 euro për çdo pagë apo të pesë pagat së bashku në shumë prej 2,816.25 €, e që në total për të gjitha format e shpërblimit ka kërkuar shumën prej 6,155.95 €. Për paditësin M.A. në emër të shpenzimeve të ushqimit ka kërkuar nga 2.5 euro në ditë apo për 1086 ditë pune në shumë prej 2,607.50 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 1086 ditë pune ka kërkuar shumën e tërësishme prej 732.20 €, në emër të dy pagave jubilarë ka kërkuar shumën e tërësishme prej 569.13 €, si dhe në emër të pagës së 13-të për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ka kërkuar nga 569.13 euro për çdo pagë apo të pesë pagat së bashku në shumë prej 2,845.65 €, e që në total për të gjitha format e shpërblimit ka kërkuar shumën prej 6,185.35 €, të gjitha me kamatë ligjore duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata, pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës, i ka dorëzuar të paditurës padinë me prova si dhe aktvendimin për përgjigje në padi, ku e ka obliguar të paditurën që t'a parashtron përgjigjen në padinë e paditësve. E paditura brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në padi edhe pse nga fletëkthesa e dt.08.09.2021 shihet se e paditura e ka pranuar me rregull aktvendimin për përgjigje në padi.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të vërtetimit të punës me numër të referencës 04/1-05-SRR-459 të dt.19.04.2021 gjykata vërtetoi faktin se paditësi i parë H.Q. është i punësuar tek e paditura që nga data 12.01.2004 dhe ka pranuar pagë mujore në lartësi prej 563.25 euro.

Në bazë të vërtetimit të punës me numër të referencës 04/1-05-SRR-696/21 të dt.23.04.2021 gjykata vërtetoi faktin se paditësi i dytë M.A. është i punësuar tek e paditura që nga data 22.07.2002 dhe ka pranuar pagë mujore në lartësi prej 569.13 euro.

Gjykata ka vendosur si në paragrafin II pika 1 dhe 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve jashtë seancës gjyqësore duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, pasi që ka vlerësuar se shpërblimi jubilar paditësve u takon sipas nenit 29 par.5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 dhe nenit 30 par.5 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës. Lidhur me lartësinë e pagesës në emër të shpërblimit jubilar për njëzet vite të përvojës së punës së paditësve gjykata mori për bazë vërtetimet e punësimit të vlerësuara si më lartë dhe në bazë të lartësisë së pagës ka vendosur që t'ua aprovoj paditësve kërkesën për shpërblimin jubilar në lartësi prej 25% të një page bazë për çdo jubile apo dhjetë vjeçar të përvojës së punës, respektivisht 50% të lartësisë së një page bazë për njëzet vite përvojë pune të kaluar tek e paditura, konform nenit 29 par.5 dhe nenit 30 par.5 të Udhëzimeve të lartpërmendura.

Ndërsa lidhur me kërkesën për shpërblimin e pagës së 13-të gjykata ka vendosur konform nenit 29 par.2, përkatësisht nenit 30 par.2 të të njëjtave Udhëzime Administrative të lartpërmendura, e cila bazë juridike gjen mbështetje edhe tek Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.213/2023 të dt.09.10.2023 në paragrafin II dhe IV të të njëjtit Mendim. Edhe në rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e shpërblimit të pagës së trembëdhjetë, gjykata është bazuar në vërtetimet e punësimit të secilit paditës, ku janë caktuar qartë lartësia e pagës bazë të secilit prej tyre.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesës sa i përket pagave jubilarë, ngase paditësit në emër të dy pagave jubilarë kanë kërkuar secili veç e veç shumën e një page të plotë (që nënkupton 100% të një page bazë) ndërsa gjykata e ka aprovuar pjesërisht dhe atë në lartësi prej 25% të një page bazë për dhjetë vite të përvojës së punës apo 50% të një page bazë për njëzetë vite të përvojës së punës, që në rastin konkret nënkupton gjysmë page, duke u bazuar në paragrafin 5 të nenit 29, respektivisht nenit 30 të Udhëzimeve Administrative të lartpërmendura, ndërsa pjesën tjetër në lartësi prej 50% apo gjysmë page tjetër e ka refuzuar si të pabazuar.

Gjykata gjithashtu e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë sa i përket kompensimit të pagës së trembëdhjetë për vitin 2022 për të dy paditësit, pasi Udhëzimi Administrativ nr. 02/2018 që e parasheh këtë të drejtë është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të UA nr. 01/2021, i cili nuk e ka paraparë në mënyrë imperative kompensimin e pagës së trembëdhjetë për punonjësit e Policisë së Kosovës.

Sa i përket kërkesave për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtave ditore) gjykata këto kërkesa i ka refuzuar në tërësi si të pabazuar, ngase sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.213/2023 të dt.09.10.2023 në paragrafin I dhe Arsyetimin për pikën I të të njëjtit Mendim, i cili parasheh që “përfshirja e shpërblimit të shujtës ditore është i karakterit deklarativ e për më tepër nuk janë përcaktuar as kushtet, mënyra, lartësia dhe realizimi i shpërblimit të shujtës ditore. Këto dispozita nuk përcaktojnë detyrime konkrete për punëdhënësin, por vetëm theksojnë se duhet të jenë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”.

Sa i përket kërkesës për kompensimin e udhëtimit, gjykata këtë kërkesë e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar ngase as me Udhëzimet Administrative të lartcekura e as me Ligjin për Policinë apo shtesave tjera për Policinë, nuk janë paraparë si formë e shpërblimit, andaj në mungesë të bazës ligjore kjo kërkesë është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u tha më sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 398 dhe 399 të LPK-së, lidhur me nenin 29 par.2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, si dhe nenin 382 të LMD-së.

Për shpenzimet e procedurës, Gjykata e ngarkoi të paditësit, konform nenit 452 par.1 të LPK-së dhe atë si vijon: për përpilimin e padisë shumën prej 156.00 €, për tarifën e paraqitjes së padisë në gjykatë, shumën prej 40.00 €, konform tarifës së OAK-së dhe UA nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Gjykata i ka detyruar paditësit që paraprakisht dhe në mënyrë solidare të paguajnë taksën gjyqësore shtesë për paraqitje të padisë në shumë prej 20.00 € duke u bazuar në nenin 12 të UA nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**2021:087355, më datë 15.04.2024**

**Gjyqtari,  
Bekim Salihu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.